

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 3.02.2025*

**3.02.2025
Ora 16:00**

RENDI I DITËS

**“Për përzgjedhjen e monitoruesve për të plotësuar vakancën në Qarkun Elbasan,
Bashkia Belsh, për zgjedhjet për Kuvend, të dates 11 Maj 2025”**

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. K. Puleri

Z. K. Puleri: Përshëndetje! Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 3 datë 03.11.2022, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, si dhe Vendimit nr. 203, datë 6.12.2024, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”, ka bërë njoftim publik në faqen zyrtare të KQZ-së për pjesëmarrje për të gjithë aplikantët, të cilët shfaqën interes për të qenë monitorues të fushatës. Me vakancën e krijuar në Qarkun Elbasan, Bashkia Belsh sot KQZ rihedh shortin për të plotësuar vakancën duke u bazuar në aplikimet që ka pasur për këtë qark. Për Qarkun Elbasan, Bashkia Belsh ka dy kandidatë, të cilët kanë aplikuar nga thirrja e cila u shpall në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 30.01.2025 të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 3 datë 03.11.2022 të KSHZ. Për këtë arsye në një enë transparente do të vendosen dy shirita me emrat e aplikantëve për monitorues dhe nga këto dy aplikantë, do të përzgjidhet vetëm 1 (një). Emrat e aplikantëve janë: Klodian Ferko dhe Xheki Maksuti. Pas futjes së shiritave, vazhdojmë me përzgjedhjen. Monitoruesi i përzgjedhur është Klodian Ferko, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

